

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1013 REJ 28.05.2001
VERIFIKOHET NJESIA ME
ORIGINALIN
NOTERIA ELIDA TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2009 Regj.Nr. 428 Kol.

Ne AKP.Nr. 655 Prot.,date 28.03.2001

Tirane, me 28.3.2001.

**KONTRATE SHITJE
PER PJESET E KAPITALIT TE ZOTERUARA NGA SHTETI SHQIPTAR NE
SHOQERINE ME KAPITAL TE PERBASHKET
"T.T.A. ALBA-LAM" SH.P.K. TIRANE**

Sot, me date 28.3.2001 (dymije e nje), ditën e martës, perpara meje noterit te Dhomes se Noterise Tirane Shamir Shkurti, me seli ne Tirane ne Agjencine Kombetare te Privatizimit Tirane, hartohet kontrata e shitjes se pjeseve te kapitalit te zoteruara nga Shteti Shqiptar ne Shoqerine "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k. Tirane, midis paleve te cilat rane dakort si me poshte:

Neni 1 - Palet

- 1.1 *Pala shiteses*: Agjensia Kombetare e Privatizimit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i saj Zj. Kozeta FINO
- 1.2 *Pala blereses*: Ortaku jo shteteror Z.Illir MATA ne Shoqerine "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k. Tirane. Shoqeria "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k Tirane eshte e njohur me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.4364 Regj., date 05.04.1993. **Ortaku jo shteteror** perfaqesohet nga administratori i saj Z.Illir MATA, i biri i Damailit dhe i Havase ,i lindur me 28.09.1961 Tirane me adrese Rruga "Hoxha Tahsim"Nr.190/1 Tirane i pajisur me pasaporte me Nr.0353632 Palet ne kete kontrate jane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe deklaruan se lidhin kontraten e shitjes si vijon.....

Neni 2 - Objekti i kontrates

- 2.1 Objekt i kesaj kontrate eshte shitja e kuotave te zoteruara nga shteti ne shoqerine "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k.Tirane, me vlere 6.384.892 (gjashte milion e treqind e tetedhjet e kater mije e teteqind e nentedhjet e dy) leke, vlere e cila perfaqeson 11.64% te kapitalit te vete shoqerise dhe i perket shtetit Shqiptar, vlere e cila perbehet nga vlere e kapitalit shteteror 3.117.335(tre milion njeqind e shtatembedhjet mije e treqinde tridhjet e pese) leke plus vlere 3.267.557(tre milion e dyqind e gjashtedhjet e




shtate mije e peseqind e pesedhjet e shtate) leke qe eshte vlere e tokes me siperfaqe prej 2870(dymije e teteqind e shtatedhjet) metra katrore.....
Vleresimi i pjeseve te kapitalit te shoqerise eshte bere ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi nga Eksperti Kontabel i Autorizuar Z. Adrian Liko, date 20.11.1998.
Shitja e pjeseve te kapitalit shtetedor bazohet ne vendimet e Asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie date 12.08.1998 dhe miratimit te Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit me shkresen Nr.2984 Prot. date 27.7.1998.

Neni 3 - Çmimi i shitjes

- 3.1 Çmimi i shitjes se pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti. ne shoqerine "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k.Tirane, eshte 6.384.892 (gjashte milion e treqind e tetedhjet e kater mije e teteqind e nentedhjet e dy) leke, vlere e paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken Kombetare Tregtare, Dega Tirane Nr.1, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjencise Kombetare te Privatizimit, respektivisht me mandat-pagese Nr.206583 dt.30.01.2001 me vlefte 624.000 (gjashteqind e njezet e kater mije)leke, mandat-pagese Nr.008879 dt.02.02.2001 me vlefte 653.000 (gjashteqind e pesedhjet e tre mije) leke dhe mandat-pagese Nr.0232063 date 16.03.2001 me vlefte 5.107.892 (pese milion e njeqind e shtate mije e teteqind e nentedhjet e dy).....
- 3.2 Pala shitesese deklarone se ne favor te saj eshte derdhur e gjithë shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate.

Neni 4 - Kushtet e shitjes

- 4.1 Pjesa e kapitalit te zoteruar nga shteti qe shitet eshte pershkruar ne menyre korrekte, ne perputhje me dokumentacionin derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me shkresat Nr.6414/1 Prot.,date 20.01.1999,Nr.1035 Prot.date16.02.1999 dhe Nr.2462 Prot., date 13.04.1999 etj. perpara perpilimit te kesaj kontrate.
- 4.2 Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitesese ne autorizimin Nr.334 Prot., date 15.02.2001 te Agjencise Kombetare te Privatizimit Tirane.....
- 4.3 Pala shitesese garanton bleresin se kapitali, objekt i kesaj kontrate eshte i lire nga çdo detyrim apo barre ligjore, detyrim apo kerkese ndaj çdo personi te trete (publik apo privat).....
- 4.4 Pala blerese pas nenshkrimimit te kesaj kontrate, noterimit te saj dhe pas regjistrimit te pasurise ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme te Rrethit Tirane eshte pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me kete pasuri qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.....



Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e pjeseve te kapitalit transferohet nga ortaku shteteror tek ortaku jo shteteror, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.....
 Pala shitese merr persiper te mbroje vlefshmerine e kesaj kontrate shitje ne rast cenimi te saj prane Sistemit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise konform legjislacionit mbi te cilin eshte nenshkruar.....

Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit

- 5.1 Bleresi ka pranuar blerjen e pjeseve te kapitalit shteteror ne "T.T.ALBA-LAM" Sh.p.k. Tirane me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te dates 12.08.1998.....
- 5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi pjeset e kapitalit shteteror te blere prej tij pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.....
- 5.3 Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.....
- 5.4 Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per rregjistrimin e pasurive te paluajteshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajteshme te Rrethit Tirane. Ne te kundert, ne baze te nenit 12 te ketij ligji me kalimin e ketij afati detyrohet te paguaje nje gjobe ditore prej 10% te vleres se rregjistrimit per çdo dite vonese.....
- 5.5 Pala blerese pas nenshkrimit, noterizimit te kesaj kontrate dhe rregjistrimit behet pronar i vetem me te drejta te plota te kapitalit te pergjithshem te Shoqerise "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k Tirane.

Neni 6 - Baza ligjore per lidhjen e kontrates

- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
- Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
- VKM Nr. 230, date 04.04.1998;
- VKM Nr. 21, date 21.01.1999;
- Udhezimi Nr. 2/1, date 16.06.1998;
- Udhezimi Nr. 1, date 01.03.1999.
- Udhezimi Nr.1/1, date 02.11.2000

Neni 7 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate

- 7.1 Akti i vleresimit te truallit te "T.T.A.ALBA-LAM"Sh.p.k.Tirane perpiluar nga Bashkia e Tiranës me shkresen Nr.8315/1 Prot., date 10.11.1998 me nje flete fotokopje
- 7.2 Harta treguese e shoqerise "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k. Tirane me shkresen Nr.60/2 e dates 19/02/2001 dhe planimetria e saj.

- 7.3 Raporti i vleresimit te pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti ne "T.T.A.ALBA-LAM" Sh.p.k. Tirane pergatitur nga eksperti kontabel i autorizuar Z. Adrian Liko date 20.11.1998 me nje fotokopjo te noterizuar.....
- 7.4 Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr 2984 Prot., date 27/7/1998 "Miratim per privatizimin e pjeses se kapitalit shteteror ne shoqerite me kapital te perbashket"
- 7.5 Autorizimi i AKP.Nr.334 Prot., date 15.02.2001 me dy flete origjinal
- 7.6 Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.496/1 Prot., date 18/01/2001 derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit

Neni 8 – Te ndryshme

- 8.1 Pala shitese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote dhe po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim.Kjo kontrate shitje, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te barabarte. Kontrata perbehet nga 4 (kater) flete. Nje kopje e kontrates qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjencise Kombetare te Privatizimit, dhe dy kopje i merr pala blerese.. Une noterja , ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e pjeseve te kapitalit shteteror e vertetoj ate sipas ligjit.....

Tirane, me 26.5. 2001.


PALET KONTRATUESE

PALA SHITese

Agjencia Kombetare e Privatizimit

Kozeta FINO

Drejtor i Pergjithshem



NOTER

PALA BLERESE

Z. Ilir MATA

(Handwritten signature of Z. Ilir MATA)

(Large handwritten signature)